



Tirana International Airport SHPK ("TIA") kërkon të punësojë:

## Shofer

### Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë e pozicionit:

*(Vetëm për udhëzim. Përgjegjësitë e përmendura më poshtë mund të ndryshojnë në momentin e rekrutimit.)*

- Sigurimi i transportit të sigurt dhe të rehatshëm për CIP, me prioritet mbrojtjen dhe shërbimin e kërkuar.
- Mbajtja e shënimeve të sakta dhe të përditësuara për fletët e udhëtimit, raportet e incidentëve, raportet e aksidenteve dhe gjendjen e automjeteve.
- Kryerja e riparimeve dhe shërbimeve të nevojshme për automjetet, nëpërmjet dyqaneve të përcaktuara.
- Transportimi i faturave dhe dokumenteve të TIA-s, si dhe personelit dhe bashkëpunëtorëve.
- Sigurimi i mirëmbajtjes së automjeteve, furnizimi me karburant dhe pastrimi i rregullt i tyre.
- Blerja e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për administratën e CIP.
- Asistimi në transportimin e materialeve dhe pajisjeve brenda ambienteve të TIA-s.
- Duhet të mirëmbajë dhe të ruajë informacionet konfidenciale të cilat dhe/ose të dhëna të cilat mund të konsiderohen si "sekrete biznesi" duke ruajtur informacionin dhe jo duke e bërë publik te palët e treta.

### Aftësitë e kërkuara:

- Diplomë e shkollës së mesme
- Patenta e vlefshme për drejtimin e automjetit
- Aftësi për të punuar në grup dhe për të ndjekur udhëzimet e drejtuesve
- Nivel i mesëm i anglishtes së folur
- Aftësi për të lëvizur dhe ngritur peshë të rënda
- Aftësi për të punuar nën stres dhe për të reaguar në urgjencat
- Ndershmëri, besueshmëri dhe integritet

Për të aplikuar për këtë pozicion aplikantët duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit, i cili mund të gjendet tek faqja e internetit: [www.tirana-airport.com](http://www.tirana-airport.com) dhe të dërgohet me postë elektronike së bashku me një CV të kohëve të fundit në: [human-resources@tirana-airport.com](mailto:human-resources@tirana-airport.com), ose tek recepsioni i Godinës së Administratës (Rinas).

**Afati i aplikimeve: 29/11/2024**

Departamenti i Burimeve Njerëzore do të kontaktojë për intervistë vetëm aplikantët e kualifikuar.